

Banka e Shqipërisë

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

TREMUJORI II

ERJONA SULJOTI

SOFIKA NOTE

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, BANKA E SHQIPËRISË

KORRIK 2012

** Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Avni Rustemi" Nr.24, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org*

www.bankofalbania.org


P Ë R M B A J T J A

1.	<i>BANKAT DHE NDËRMJETËSIMI FINANCIAR</i>	5
1.1	<i>ECURIA E NDËRMJETËSIMIT</i>	6
1.2	<i>KOSTOT E NDËRMJETËSIMIT</i>	7
1.3	<i>ECURIA E ELEMENTEVE JO-KOSTO NË NDËRMJETËSIM</i>	9
2.	<i>ZHVILLIMET NË DEPOZITA</i>	9
3.	<i>ZHVILLIMET NË KREDI</i>	11

1. BANKAT DHE NDËRMJETËSIMI FINANCIAR

Gjatë viteve të fundit, monetizimi në rritje i ekonomisë ka krijuar kushtet e përshtatshme që sistemi bankar të luajë një rol aktiv në ndërmjetësimin financiar. Megjithatë, ecuria e ndërmjetësimin financiar në tremujorin e dytë të vitit 2012 ka qenë e kushtëzuar nga një kërkesë e dobët e sektorit privat për para. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në vend nën nivelin potencial ka ulur kërkesën për financim të sektorit privat. Bankat e nivelit të dytë vijojnë të jenë përzgjedhëse në financimin e sektorit privat, duke preferuar më shumë financimin e bizneseve. Pësia e portofolit të kredisë për biznese ka arritur në 74% të totalit në muajin maj, ndërkohë portofoli i kredisë për individë po vijon të tkurret. Zhvillimet në tregun e punës dhe pasiguria për të ardhmen, të shoqëruar me tendencën e individëve për të kursyer, vlerësohet se kanë ndikuar në një kërkesë të ulët për para. Perceptimi¹ i situatës së përgjithshme makroekonomike si dhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme, kanë dëmtuar kërkesën për kredi hipotekore dhe njëkohësisht kanë kushtëzuar ecurinë e financimit të individëve. Ndërkohë, mungesa e investimeve ose shtyrja në kohë e tyre, kanë ndikuar në rënien e kërkesës për financim për këtë qëllim nga bizneset. Kërkesa e bizneseve shfaqet e moderuar dhe e orientuar kryesisht për qëllime likuiditeti.

Grafik 1. Kredia e sektorit privat dhe depozitat në raport me PBB-në, (në %).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tërësi sistemi bankar vlerësohet të jetë likuid dhe i mirëkapitalizuar. Ndërkohë, ecuria e ngadaltë e ekonomisë, diferencat në zhvillimet sektoriale si dhe përkeqësimi i cilësisë së portofolit të kredisë në 20.1% në fund të muajit mars (përkundrejt 18% një viti më parë), i ka shtyrë bankat të jenë të kujdesshme në lehtësimin e kushteve të kredidhënies dhe përzgjedhëse në projektet që ato financojnë. Ndërmjetësimi financiar, i matur si raport i kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së, ka mbetur i pandryshuar me nivelin e

¹ Sikurse vlerësohet nga vrojtimitet e aktivitetit kreditues për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2012.

vitit 2011, në 40.8%². Ndërkohë, raporti i depozitave ndaj PBB-së prej 68.9% ka vijuar prirjen rritëse, duke qenë rreth 1.7 pikë përqindje më lartë se fundi i vitit 2011.

Ecuria e ngadaltë e aktivitetit kreditues përballë tendencës së individëve për kursim, ka ndikuar në rënien e raportit të kredisë ndaj depozitave totale në fund të muajit maj. Ky raport shënoi 61.6% ose 0.8 pikë përqindje më i ulët se në maj të vitit 2011. Ndërkohë, në ndërmjetësimin sipas monedhave vihet re ecuria më e mirë e ndërmjetësimit në lekë.




1.1 ECURIA E NDËRMJETËSIMIT

Ndërmjetësimi në monedhën vendase në tremujorin e dytë të vitit ka shfaqur një ecuri të qëndrueshme, i karakterizuar nga ruajtje në të njëjtat nivele të raportit kredi/depozita. Në fund të muajit maj, ky raport shënon 41.8%. Në një krahasim më të shtrirë në kohë, ndërmjetësimi në lekë ka ndjekur një trend rritës në 12 muajt e fundit. Raporti kredi/depozita në fund të muajit maj është rritur me 3.3 pikë përqindje kundrejt një viti më parë, si rrjedhojë e ecurisë së mirë të kredisë në lekë, e cila është rritur me një ritëm vjetor rreth 2 herë më të lartë se ritmi i rritjes së depozitave në lekë.

Ndërmjetësimi në valutë ka shënuar ngadalësim të lehtë gjatë tremujorit të dytë. Në fund të muajit maj, raporti kredi/depozita në valutë shënoi 83.2%, duke rënë me 1.0 pikë përqindje kundrejt fundit të tremujorit të parë të vitit. Një ecuri e tillë është përcaktuar nga tkurrja e lehtë e portofolit të kredisë në valutë në këta dy muaj, ndërkohë që depozitat në monedhë të huaj janë rritur në këtë periudhë, ndonëse në masë të moderuar krahasuar me periudha të mëparshme. Gjatë 12 muajve të fundit, shkalla e ndërmjetësimit në valutë

² Krahas ecurisë së treguesve financiar ky raport ka reflektuar edhe rishikimet e serisë së PBB-së. Rishikimi më i fundit i PBB-së, korrik 2012, botim i INSTAT.

Grafik 3. Ecuria e ndërmjetësimit në lekë dhe në valutë.




vijon të reduktohet ndjeshëm, si edhe në dy vitet e mëparshëm. Raporti kredi/depozita në fund të muajit maj është rreth 6.3 pikë përqindjeje më i ulët se muajin maj të vitit të kaluar.

1.2 KOSTOT E NDËRMJETËSIMIT

Pas rritjes së shënuar në tremujorin e katërt të vitit të kaluar dhe në tremujorin e parë të këtij viti, kostoja mesatare e ndërmjetësimit në lekë në tremujorin e dytë ka mbetur thuajse e pandryshuar, në 6.85 pikë përqindje. Qëndrueshmëria e kostonë së ndërmjetësimit në monedhë vendase, ka ardhur si rrjedhojë e reduktimit të njëkohshëm dhe me të njëjtën masë të normave të interesit të depozitave dhe kredive në lekë gjatë kësaj periudhe. Ecuria e këtyre të fundit duket se ka ndjekur sinjalet e politikës monetare të muajve të mëparshëm, të dhënë nëpërmjet reduktimit të normës bazë. Kjo vihet re

Grafik 4. Ecuria e kostonë së ndërmjetësimit në lekë*.




* Marzhi llogaritet si diferencë mes normave të interesit të kredisë dhe atyre të depozitave. Spread-i llogaritet si diferencë mes normës së interesit të kredisë/depozitave dhe asaj referencë (bono thesari 12-mujore për lekun dhe Euribor 12-mujor për euron).
Burimi: Banka e Shqipërisë.

edhe në një krahasim më të shtrirë në kohë. Kështu, në harkun kohor të një viti, kostoja e ndërmjetësimit në lekë ka rënë me 0.3 pikë përqindje, si pasojë e reduktimit të normës së interesit të depozitave me 0.4 pikë përqindje dhe e reduktimit të kredisë me 0.7 pikë përqindje. Gjithashtu, rënia e normave të interesit të kredisë dhe rritja e yield-eve të bonove të thesarit në muajt e fundit kanë ndikuar në reduktimin e spread-it mes tyre në tremujorin e dytë të vitit. Aktualisht, ky spread për tremujorin e dytë është mesatarisht 3.8 pikë përqindje, rreth 0.7 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë, i ndikuar plotësisht nga rënia e normave të interesit të kredisë në lekë.

Kostoja mesatare e ndërmjetësimit në euro³ rezultoi 4.93 pikë përqindje në tremujorin e dytë të vitit, duke shënuar një rritje të lehtë prej 0.13 pikësh përqindjeje kundrejt nivelit mesatar të tremujorit të parë. Ndërkohë që norma mesatare e interesit të depozitave ka mbetur e pandryshuar, rritja e lehtë e kostonë së ndërmjetësimit në euro është shkaktuar nga rritja e normës së interesit të kredisë në këtë monedhë. Pavarësisht këtyre zhvillimeve afatshkurtra, kostoja e ndërmjetësimit në euro në tremujorin e dytë të vitit rezulton pranë mesatares së saj në 12 muajt e fundit, e cila është 0.3 pikë përqindje më e ulët se sa ajo e 12 muajve të mëparshëm.


Normat e depozitave në euro në vend mbeten ndjeshëm më të larta se sa normat për këtë monedhë në tregjet ndërkombëtare, të cilat kanë shënuar rënie të ndjeshme në gjashtë muajt e fundit. Faktori kryesor pas këtij fenomeni mbetet nevoja e bankave në vend për të siguruar likuiditetin në valutë. Për rrjedhojë, ulja e normave të interesit për euron në tregjet ndërkombëtare, shoqëruar me qëndrueshmërinë relative të normave të interesit për këtë monedhë në vend, është materializuar në rritjen e spread-i mes tyre në muajt e fundit.



³ Veprimtaria e bankave në valutë është e dominuar nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.

1.3 ECURIA E ELEMENTEVE JO-KOSTO NË NDËRMJETËSIM⁴

Analiza e aktivitetit kreditues në tremujorin e dytë të këtij viti tregon për shtrëngim të mëtijshëm të kushteve të kreditimit për bizneset dhe mbajtje të pandryshuar të atyre për individë. Pothuajse të gjithë elementët jo-kosto të këtyre kushteve vijojnë të veprojnë në kahun shtrëngues.



Kërkesat për kolateral dhe maturiteti maksimal i kredisë mbeten elementët kryesorë me ndikim më të fortë shtrëngues, ndër elementët jo-kosto të kreditimit. Ndërkohë, edhe elementët kosto të kushteve të kreditimit vijojnë të veprojnë në kahun shtrëngues, me një efekt të shtuar në dy tremujorët e fundit.

Kushtet e financimit për individët, pasi u shtrënguan në tremujorin e parë të vitit, mbetën të pandryshuara në tremujorin e dytë të tij. Elementët jo-kosto që kanë dhënë efektin më të madh në kahun shtrëngues janë kërkesat për kolateral dhe raporti kësht/të ardhura. Gjithashtu, për të dytin tremujor radhazi, elementët kosto të kushteve të kreditimit për individë vijojnë të veprojnë gjithashtu në kahun shtrëngues.


2. ZHVILLIMET NË DEPOZITA

Në tremujorin e dytë të vitit 2012, depozitat e sistemit bankar kanë ruajtur të njëjtat ritme rritjeje sikurse edhe në tremujorin e parë. Kjo ecuri është mbështetur nga monetizimi në rritje i ekonomisë dhe tendenca për të kursyer e individëve. Raporti i depozitave ndaj M3 u rrit në 82.8% ose 1.6 pikë përqindje më e lartë se në muajin maj 2011.

⁴ Kjo analizë bazohet në rezultatet e Vrojimit të Aktivitetit Kreditues që zhvillohet çdo tre muaj nga Banka e Shqipërisë. Për më shumë shiko www.bankofalbania.org publikime.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit, depozitat janë rritur me 23.4 miliardë lekë, mbështetur nga rritja prej 18 miliardë lekësh e depozitave në lekë. Në terma vjetorë, depozitat në lekë kanë ngadalësuar lehtësisht normën e rritjes, duke e zbritur atë në 9% dhe duke reflektuar reduktimin e normave të rritjes të depozitave me afat në lekë. Kështu, norma vjetore e depozitave me afat në lekë, në muajin maj, shënonte 9.6% përkundrejt 12.8% një vit më parë. Ky ngadalësim, është ndikuar edhe nga preferenca e individëve për të investuar kursimet e tyre në bono thesari në treg primar. Gjithashtu, rritje kanë shfaqur edhe investimet e individëve në institucione financiare jobanka⁵. Këto zhvillime konfirmojnë preferencën e ulët të individëve për të mbajtur para likuide dhe tendencën e tyre drejt kursimit.

Depozitat pa afat në lekë janë rritur mesatarisht me 1.5 miliardë lekë në muaj në ndryshim nga tkurrja e tremujorit tëparë, e ndikuar kryesisht nga ecuria e depozitave të institucioneve financiare në sistemin bankar. Ndërkohë, rritja vjetore e depozitave pa afat shënoi 6.2% dhe ka ndjekur trajektore rritëse të fillim të vitit. Kjo ecuri është ndikuar edhe nga tkurrja e depozitave pa afat një vit më parë. Depozitat e bizneseve private në lekë pa afat, janë luhatur rreth nivelit mesatar të 2-3 viteve të fundit.




Raporti i depozitave në valutë ndaj totalit në muajin maj është reduktuar lehtësisht, duke zbritur në 47.7% përkundrejt 48.3% që shënonte në muajin dhjetor. Reduktimi i peshës së depozitave në valutë ndaj totalit është ndikuar si nga ngadalësimi i normave të rritjes së depozitave në valutë ashtu dhe nga ecuria e mirë e depozitave në lekë. Në tremujorin e dytë të vitit depozitat në valutë janë rritur mesatarisht me 2 miliardë lekë, duke shfaqur përmirësim krahasuar me tremujorin e parë. Në terma vjetorë, depozitat në valutë shënuan një rritje vjetore rreth 13%, të ngjashme me fundin e vitit 2011. Gjithsesi, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, norma

⁵ Këto institucione nuk përfshihen në treguesit monetarë.

vjetore e rritjes së depozitave në valutë ka vijuar trajektoren rënëse të nisur që nga mesi i vitit 2011. Kjo ecuri ka reflektuar flukset valutore më të ulëta se një vit më parë dhe krijimin më të pakët të parasë në valutë. Rritja e depozitave në valutë është mbështetur nga depozitat me afat të individëve. Ndërkohë, që në tremujorin e dytë, depozitat pa afat kanë shfaqur përmirësim të moderuar të normave vjetore të rritjes, në 3.2%.

3. ZHVILLIMET NË KREDI

Kredia për ekonominë ka vijuar ngadalësimin vjetor edhe në tremujorin e dytë të këtij viti. Rritja vjetore e saj shënoi 9.4%, nga 10.9% dhe 12.2% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorit të parë të këtij viti dhe në fund të vitit të kaluar. Në një masë të madhe, ky ngadalësim reflekton kërkesën e ulët të sektorit privat për financim, në reflektim të kërkesës së dobët të brendshme. Në të njëjtën kohë, edhe oferta për kredi, pavarësisht situatës së mirë të kapitalizimit dhe likuiditetit të sistemit bankar, paraqitet e shtrënguar, sikurse tregohet nga ecuria e kushteve të kreditimit. Sjellja e kujdesshme dhe përzgjedhëse e bankave në kreditim, vjen në përgjigje të rritjes së rrezikut të




kredisë në vend dhe shtimit të pasigurive për të ardhmen.

Kredia në lekë mbetet nxitësi kryesor i rritjes së kredisë në ekonomi. Rritja vjetore e saj, pasi ra në 16.0% në muajin prill, u përmirësua sërish në muajin maj, duke shënuar 18.3%. Zgjerimi i saj në muajin maj, ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së financimit për qëllime investimi për ndërmarrjet publike. Duke përjashtuar këtë financim, zgjerimi i kredisë në lekë mbetet i ulët krahasuar me muajt e vitit të kaluar.

Kredia në valutë ka vijuar ngadalësimin edhe në tremujorin e dytë të vitit. Rritja vjetore e saj shënoi 5.0% në muajin maj, nga 7.3% dhe 8.3% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorit të parë të këtij viti dhe në fund të vitit të kaluar.

Grafik 9. Ecuria e kredisë në lekë (majtas) dhe valutë (djathtas) sipas qëllimit të përdorimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përveç kërkesës përgjithësisht të ulët për financim, ecuria e dobët e kredisë në valutë është ndikuar edhe nga zhvendosja e preferencave të individëve dhe bizneseve për monedhën e financimit drejt lekut. Monedhat e huaja, kryesisht euro, mbeten kryesore në kreditë për qëllime investimi. Ndërkohë, në kredinë për likuiditet, vihet re një përdorim më i madh i monedhës vendase në dy vitet e fundit në krahasim me vitet e mëparshme. Përdorimi më i pakët i valutës në kredimarrje vihet re veçanërisht tek individët. Në një kohë kur kredia në valutë për individë ka mbi dy vjet që shënon tkurrje të vazhdueshme, kredia në lekë ka patur ecuri të mirë duke kompensuar tkurrjen e kredisë në valutë.